



INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj

**INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 - 16

RAPORTI I AUDITUESVE LIGJORË

Ortakëve dhe Drejtimit të Shoqërisë “INC S.p.A” Degë e Shoqërisë së huaj

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “INC S.P.A” (Degë e Shoqërisë së huaj), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar me datën 31 Dhjetor 2024, Pasqyrën e të Ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Ndryshimeve në Kapital dhe Pasqyrën e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqërisë tregetare “INC S.P.A” (Degë e Shoqërisë së huaj), më 31 dhjetor 2024, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (Kodi i IESBA) bashkë me kërkesat e etikës që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësia e Audituesit

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, auditori :

- Identifikon dhe vlerëson rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, planifikon dhe kryen procedurat përkatëse të auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, si dhe merr evidenca të njafueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin e tij.

- Siguron njohje të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme sipas rrethanave , por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.

-Vlerëson përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe te cmuarjeve kontabël të kryera , si dhe të shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.


-Shprehet në lidhje me parimin e vijimësisë bazuar në evidencat e siguruar gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston dhe që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrihet në përfundimin që një pasiguri materiale ekziston, audituesi është i detyruar të shprehet në raportin e auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës , ose nëse shënimet shpjeguese janë të papërshtatshme , të modifikojë opinionin e tij për pasqyrat financiare.

-Vlerëson paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë që të arrijnë paraqitjen e drejtë.

Gjatë auditimit auditori komunikon me personat përgjegjës të ngarkuar për drejtimin e Shoqërisë, dhe i bën të ditur Drejtimin përveçse çështjeve të tjera edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet kryesore të auditimit.Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

29 MARS 2025
Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor
Enkelejda Alite



Auditues Ligjor
Sherife Hoxha



INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Aktive afatgjata materiale, neto	5	6,590,745	5,184,490
Aktivet me të drejtë përdorimi, neto			-
Aktive tatimore të shtyra			-
Totali i aktiveve afatgjata		6,590,745	5,184,490
Parapagime furnitorë	7	16,936,201	62,462,081
Inventari		82,526,409	7,665,720
Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera	6	1,158,142,731	868,379,007
Të drejta të arkëtueshme tatimore dhe të tjera		6,559,256	16,903,936
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	8	247,848,516	425,676,731
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,512,013,113	1,381,087,475
Totali i aktiveve		1,518,603,858	1,386,271,965
KAPITALI			
Kapital aksionar			-
(Humbja) e akumuluar		595,923,387	46,874,481
Fitimi/(Humbja) e vitit		375,080,827	549,048,906
Totali i kapitalit		971,004,214	595,923,387
DETYRIMET			
Huamarrje nga Shoqëria mëmë		-	-
Detyrime qiraje afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit dhe të tjera	9	546,673,277	700,064,964
Të pagueshme për punonjësit dhe detyrime të tjera tatimore	10	926,368	90,283,612
Parapagime te marra		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		547,599,644	790,348,577
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,518,603,858	1,386,271,965

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 16 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyra e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	11	2,431,125,060	3,334,129,002
Të ardhura të tjera		367,986	-
Totali i të ardhurave		2,431,493,046	3,334,129,002
Lëndë e parë, puntori dhe materiale të konsumueshme	12	(1,876,652,972)	(2,609,565,012)
Shpenzime personeli	13	(9,426,968)	(7,879,512)
Shpenzime amortizimi për aktivet afatgjata materiale	5	(1,152,056)	(1,048,422)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		(78,856,855)	(60,213,716)
Shpenzime financiare, neto	14	(19,662,924)	(9,482,452)
Totali i shpenzimeve		(1,985,751,775)	(2,688,189,114)
Fitimi / (Humbja) para tatimit		445,741,270	645,939,889
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(70,660,444)	96,890,983
Fitimi / (Humbja) e vitit		375,080,827	549,048,906
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		375,080,827	549,048,906

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar nga:

Lucio Maria Perilli



INC S.p.A.

BRANCH ALBANIA

Bulevardi "Deshmoret e Kombit"
 Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati 10
 Tirana 1001, - ALBANIA
 NIPT: L91330024U

Lucio Maria Perilli

Përfaqësuesit ligjor

Roberto Russo



INC S.p.A.

BRANCH ALBANIA

Bulevardi "Deshmoret e Kombit"
 Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati 10
 Tirana 1001, - ALBANIA
 NIPT: L91330024U

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 16 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	(Humbje) / Fitimi e mbartur	Totali
Gjendja më 01 janar 2022	-	-	(162,589,195)	(162,589,195)
Fitimi / (Humbja) e vitit	-	-	209,463,676	209,463,676
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	-	46,874,482	46,874,482
Gjendja më 01 janar 2023	-	-	46,874,482	46,874,482
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	549,048,906	549,048,906
Gjendja më 31 dhjetor 2023	-	-	595,923,387	595,923,387
Gjendja më 01 janar 2024	-	-	595,923,387	595,923,387
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	375,080,827	375,080,827
Gjendja më 31 dhjetor 2024	-	-	971,004,214	971,004,214

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 16 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Aktiviteti operativ		
Fitimi / (Humbja) e periudhes	375,080,827	549,048,906
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Amortizimi i aktiveve materiale dhe jomateriale	5 1,152,056	1,048,422
Zëra jo monetarë		(102,500)
Fitime nga shitja e aktiveve materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënië/(Rritje) në të drejtat e arkëtueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	(233,893,164)	(515,898,178)
Rritje/(Rënie) në parapagime	(153,391,687)	(736,156,355)
Rritje në shpenzimet e shtyra		
Rritje/(Rënie) në të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit dhe të tjera	(89,357,246)	
Rritje në të pagueshme për shpenzime të konstatuara		
Rënië/(Rritje) në inventarë	(74,860,689)	(7,665,720)
Fluksi i mjete monetare gjeneruar/(përdorur) nga aktiviteti operativ	(175,269,904)	(709,725,426)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(2,558,311)	(1,877,928)
Të arkëtueshme nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-
Fluksi i mjeteve monetare i përdorur në aktivitetin investues	(2,558,311)	(1,877,928)
Huamarrje nga Shoqëria mëmë		-
Detyrimi i qirasë		-
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti financues		-
Rritja/(Rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	(177,828,215)	(711,603,354)
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	425,676,731	1,137,280,085
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	247,848,516	425,676,731

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 16 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj (“Shoqëria”) është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L91330024U, në datën 30 janar 2019, me numër rregjistrimi fillestar CN-080081-01-19. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit “Për Shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe nga statuti i saj. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë konsiston në ndërtues, si kontraktor i përgjithshëm dhe promotor drejtpërdrejt apo nëpërmjet shoqerive të tjera.

Adresa e selisë së Shoqërisë është Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati 10, Tiranë. Adresa dytesore e Shoqërisë është: Tirane Vore - Muçaj - Rikonstruksion i linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe ndërtim i linjes se re hekurudhore per ne Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit - Tirane, Nr Pasurie 142/14, volumni 5, Faqe 197, Zona Kadastrale 2726.

Shoqëria është Degë e shoqërisë së huaj INC S.p.A. me seli në Torino, Itali. Aktiviteti ekonomik i Shoqërisë Mëmë konsiston në zhvillimin e projekteve të rëndësishme publike italiane në fushën e ndërtimit industrial, civil dhe infrastrukturës.

Përfaqësues ligjor të Shoqërisë janë Z. Lucio Maria Perilli dhe Z. Roberto Russo.

2. BAZA E PËRGATIJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet kryesore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme.

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në vecanti, informacioni mbi elemente të rëndësishëm të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimin kritik në aplikimin e politikave kontabël që kanë një efekt shumë të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare, përshkruhet në shënimet shpjeguese përkatëse të pasqyrave financiare.

Jeta e aktiveve afatgjata materiale: Vlerësimi i jetëgjatësisë së dobishme të zërave të aktiveve afatgjata materiale është një çështje gjykimi bazuar në përvojën me aktive të ngjashme. Përfitimet ekonomike të ardhshme të mishëruara në aktive konsumohen kryesisht nëpërmjet përdorimit. Megjithatë, faktorë tjerë, të tillë si vjetërimi dhe konsumimi teknik ose tregtar, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të mishëruara në aktive. Menaxhimi vlerëson jetëgjatësinë e mbetur të dobishme në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës aktivet pritet të kenë përfitime për Shoqërinë. Faktorët kryesorë të mëposhtëm merren parasysh: (a) përdorimi i pritshëm i aktiveve; (b) konsumimi i pritshëm fizik, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimin teknik ose komercial që vjen nga ndryshimet në kushtet e tregut.

Tatimi mbi të ardhurat: Menaxhimi, pavarësisht pasigurisë së mjedisit tatimor shqiptar dhe legjislacionit ekzistues në fuqi, beson se llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është e përshtatshme për të gjitha vitet tatimore bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme, dhe se çdo kontroll tatimor i ardhshëm nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatet e operacioneve ose flukset monetare. Megjithatë, për shkak të natyrës së ligjit për tatimin mbi të ardhurat, praktikave dhe udhëzimeve të lidhura me to, nuk është e mundur të jemi të sigurt se pozicioni aktual i ligjit tatimor do të mbetet i pakundërshtuar nga autoritetet tatimore.

2.5 Parimi i vijmësisë

Në datën e raportimit të pasqyrave financiare, Shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet gjatë rrjedhjes normale të biznesit. Si rrjedhojë, Shoqëria vazhdon të aplikojë parimin e vijmësisë dhe këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të këtij parimi.

Gjithashtu, për qëllime të këtij vlersimi, Shoqëria konsideron pozicionin financiar të Shoqërisë mëmë, objektivat aktuale dhe aksesin në burimet financiare.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në pasqyrën e performancës.

Zërat jo monetarë nuk konvertohen në fund të vitit dhe maten në bazë të kostos historike (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo monetare të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit, është si vijon:

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

	Kursi i këmbimit më 31 dhjetor 2024	Kursi i këmbimit më 31 dhjetor 2023
LEK / EUR	98.15	103.88
USD/LEK	94.26	93.94

3.3 Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja historike përfshin shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktivitetit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes të kapitalizuara për aktivitetin.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të zërit në qoftë se është e mundur që në të ardhmen përfitimet ekonomike të përfshira në atë zë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e performancës kur ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve kryesore ose përbërësve të sendeve të pronës, impianteve dhe pajisjeve kapitalizohet dhe pjesa e zëvendësuar nxirret jashtë përdorimit.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetegjatësinë e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material, duke filluar nga dita e parë e muajit në të cilin vihet në përdorim. Normat e amortizimit të përdorura nga Shoqëria janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Norma e Amortizimit
Automjete	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	20%
Instalimi i sistemit IT dhe pajisje kompjuterike	25%
Instalime teknike, makineri, mjete dhe pajisje teknike specifike, instrumente	20%

3.4 Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jo materiale, të cilat konsistojnë tërësisht në programe kompjuterike, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi llogaritet në 20% duke përdorur metodën lineare. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi dhe efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësim rregjistrohen në bazë prospektive.

3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit e kalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e performancës.

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë së tij gjeneruese të parasë, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar në vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe që ka patur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme.

3.6 Inventari

Në bazë të politikave kontabël që Shoqëria zbaton, inventarët do të maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e vlerësuara për përfundimin dhe realizimin e shitjes.

Kosto përcaktohet duke përdorur metodën “hyrje e parë, dalje e parë” (FIFO).

Kosto e inventarëve përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale.

Kosto e blerjes së inventarëve përfshin çmimin e blerjes, taksat e importit dhe tatime të tjera (përveç atyre që njësia ekonomike i rikuperon nga autoritetet tatimore) dhe transportin, trajtimin dhe kosto të tjera që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes së zërave të inventarëve.

3.6 Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose një instrument kapitali të një njësie ekonomike tjetër.

Aktiv Financiar

(i) Njohja dhe matja fillestare

Aktivitet financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, siç maten më pas me koston e amortizuar, vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) dhe vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare të pasurisë dhe modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Me përjashtim të të arkëtueshmeve tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka aplikuar mjetin praktik, Shoqëria fillimisht mat një aktiv financiar në vlerën e tij të drejtë plus, në rastin e një aktivi financiar jo me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit. Të arkëtueshmet tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi ose për të cilin Shoqëria ka aplikuar përshtatshmërinë praktike maten me çmimin e transaksionit të përcaktuar në SNRF 15.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), ai duhet të krijojë flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Ky vlerësim referohet si testi SPPI dhe kryhet në një nivel instrumenti. Aktivitet financiarë me flukse parash që nuk janë SPPI klasifikohen dhe maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, pavarësisht nga modeli i biznesit.

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Instrumentat financiarë (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese

Për qëllime të matjes vijuese, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumente borxhi);
- Asetet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Asetet financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) pa riciklim të fitimeve dhe humbjeve kumulative gjatë çregjistrimit (instrumentet e kapitalit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

(iii) Zhvlerësimi

Shoqëria njih një provizion për humbjet e pritshme të kredisë për të gjithë instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

(iv) Fshirja

Aktivitet financiar janë shlyer, tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka shteruar të gjitha përpjekjet praktike për arkëtim dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rikuperimit. Fshirja përfaqëson një çregjistrim. Shoqëria mund të fshijë aktivitet financiar që janë ende subjekt i veprimtarisë së arkëtimit kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që i detyrohen sipas kontratës, por megjithatë, nuk ka pritje të arsyeshme të rikuperimit.

(v) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parave në një transaksion në të cilin janë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitet financiar janë transferuar ose në të cilën Shoqëria as transferon, as ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivitet financiar.

Shoqëria hyn në transaksione me të cilat transferon aktivitet e njohura në pasqyrën e pozicionit të saj financiar, por ruan ose të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në këto raste, pasuritë e transferuara nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, hua dhe huazime, pagesa të pagueshme, ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, siç është e përshtatshme.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe huazimeve dhe të pagueshme, neto nga kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë tregti dhe të pagueshme të tjera.

(ii) Klasifikimi dhe matja pasuese

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- Detyrimet financiare me kosto të amortizuar (hua dhe huazime).

Shoqëria nuk klasifikon asnjë pasiv financiar në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

(iii) Çregjistrimi

Një pasiv financiar çregjistrohet kur detyrimi nën pasiv shkarkohet ose anulohet ose skadon.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitet dhe pasivitet financiarë janë kompensuar dhe shumata neto është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme nga ligji për të kompensuar shumata e njohura, dhe ekziston një qëllim që ose të shlyhet në një bazë neto, ose të realizohet aktivi dhe shlyhet detyrimin njëkohësisht. Një e drejtë e tillë e shlyerjes (a) nuk duhet të varet nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë e zbatueshme ligjërisht në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrethet normale të biznesit, (ii) në rast të mospagimit dhe (iii) në rast të paftësia pague ose falimentimi.

3.8 Kapitali aksionar

Shoqëria nuk është një entitet ligjor i veçantë dhe si pasojë nuk emeton instrumentat e veta të kapitalit. Zyra Qendrore ka të drejtën të kërkojë riblerjen e investimit të vet në Degë në mjete monetare. Ky detyrim për të paguar i jep shtysë një detyrimi për vlerën aktuale të shumës së riblerjes. Nuk është praktike për të përcaktuar shumën e kësaj detyrimi ndërkohë që është e panjohur kur dhe nëse Zyra Qendrore do të kërkojë riblerjen. Si një praktikë e përshtatshme, Dega mat 'Fondet e mbetura që transferohen në Zyrën Qendrore' me vlerën që aktivitet neto mbarten në PPF sipas SNRF-ve. Shpërndarjet e fitimit kundrejt Zyrës Qendrore njihen kur shpërndahen dhe përfshihen në Pasqyrën e Fitim/Humbjeve dhe ATGJ.

3.9 Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen se janë të lidhura nëse palët janë nën kontroll të përbashkët ose nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm ose kontroll të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative. Në shqyrtimin e secilës marrëdhënie të mundshme të palës së lidhur, vëmendja i drejtohet përmbajtjes së marrëdhënies, jo thjesht formës juridike. Gjatë vitit Dega ka kryer transaksionin me palët e lidhura.

3.10 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të vlerës së marrë apo të arkëtueshme dhe përfaqësojnë llogaritë e arkëtueshme për mallrat e furnizuar minus zbritjet tregtare, kthimet dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Shoqëria i njeh të ardhurat kur shumata mund të maten me besueshmëri; kur arkëtimi i përfitimeve ekonomike është i mundur dhe kur përmbushen kritere specifike të transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve tek klienti i shoqërisë (klienti zoteron kontrollin e mallrave).

Asetet e kontratës

Një aktiv i kontratës është e drejta e vlerësimit në këmbim të mallrave ose shërbimeve të transferuara te klienti. Nëse Shoqëria kryen duke transferuar shërbime te një klient para se klienti të paguajë shumën ose para se të paguhet pagesa, një aktiv i kontratës njihet për shumën e fituar që është e kushtëzuar.

Të arkëtueshmet tregtare

Një e arkëtueshme njihet nëse një shumë që është e pakushtëzuar duhet të paguhet nga klienti (d.m.th., kërkohet vetëm kalimi i kohës para se të kryhet pagesa e shumës).

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Detyrimet e kontratës

Një detyrim i kontratës është detyrimi për të transferuar mallra ose shërbime tek një klient për të cilin Shoqëria ka marrë shpërblim (ose një shumë e shumës është e pagueshme) nga klienti. Kur klientët paguajnë konsideratë para se Shoqëria të transferojë mallra ose shërbime te konsumatori, detyrimet e kontratës në formën e parapagimeve njihen kur pagesa kryhet.

3.11 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera operative përfshijnë të ardhura që nuk gjenerohen rregullisht gjatë rrjedhës normale të aktivitetit ekonomik, përfshirë fitimet nga shitja e elementeve të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale etj.

3.12 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet e detyrueshme sipas legjislacionit vendor. Kostot e bëra në ngarkim të Shoqërisë ngarkohen në fitim dhe humbje kur ndodhin.

3.13 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e performancës, përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen fiskale të vitit, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15% (2023: 15%).

3.14 Provizionet

Provizionet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke u zbritur vlerën e pritshme të rrjedhës së mjeteve monetare të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi që një rrjedhje burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, të jetë e nevojshme për mbylljen e detyrimit, provizionet rimerren. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provizion për humbjet e ardhshme operative.

3.15 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion në shënime të pasqyrave financiare, për aq kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues për aq kohë sa ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

3.16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje që ka ndodhur pas datës së raportimit, të cilat kërkojnë shënime informative shtesë apo rregullime në informacionin shpjegues të këtyre pasqyrave financiare.

4. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Detyrimet kryesore financiare të Shoqërisë, përbëhen nga detyrimet tregtare dhe të tjera të pagueshme. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është financimi i veprimtarisë së Degës dhe sigurimi i garancive për të mbështetur operacionet e saj.

Aktivitet kryesore financiare të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e tjera të arkëtueshme, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, dhe paratë dhe depozitat afatshkurtra që rrjedhin drejtpërdrejt nga operacionet e saj.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të tregut, rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit të paraqitur më poshtë. Drejtuesit e lartë të Shoqërisë mbikëqyrin menaxhimin e këtyre rreziqeve.

INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

5. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2024 janë të përbëra si mëposhtë:

Kosto	Makineri prodhimi	Instalime teknike dhe pajisje	Pajisje informatike dhe programe kompjuterike	Të tjera	Mjete transporti	Totali
Më 01 janar 2024	-	-	397,317	164,887	7,861,743	8,423,948
Shtesa	-	-	-	2,558,311	-	2,558,311
Rënie	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	-	-	397,317	2,723,198	7,861,743	10,982,260
Amortizimi i akumuluar						
Më 01 janar 2024	-	-	(167,087)	(97,340)	(2,975,023)	(3,239,450)
Shtesa	-	-	(57,558)	(117,153)	(977,344)	(1,152,055)
Rënie	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	-	-	(224,644)	(214,503)	(3,952,368)	(4,391,514)
Vlera neto kontabël						
Më 01 janar 2024	-	-	230,231	67,538	4,886,721	5,184,490
Më 31 dhjetor 2024	-	-	172,673	2,508,695	3,909,377	6,590,745

Asnjë aktiv afatgjatë material nuk është vendosur si kolateral ndaj financimeve me palë të treta në 31 dhjetor 2024.

INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

6. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Më 31 dhjetor 2023</u>
Hekurudha Shqiptare	1,158,142,731	-
Albanian Railway JSC	-	845,587,874
ECM	-	22,771,659
ALB-STAR	-	19,474
Total	<u>1,158,142,731</u>	<u>868,379,007</u>

Gjatë periudhës raportuese, të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit janë tërësisht të lidhura me Kontratat kryesore të Shoqërisë.

7. Shpenzime të shtyra dhe të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme tatimore dhe të tjera më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Më 31 dhjetor 2023</u>
Parapagime furnitorë	16,936,201	62,462,081
Total	<u>16,936,201</u>	<u>62,462,081</u>

8. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to më 31 dhjetor 2024 përbëhen si mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Më 31 dhjetor 2023</u>
Banka		
në valutë	214,961,593	312,378,946
në monedhë lokale	32,786,675	113,216,264
Arka ne Lek	100,247	81,521
Total	<u>247,848,516</u>	<u>425,676,731</u>

Shoqëria zotëron mjete monetare dhe ekuivalentët e saj në llogaritë rrjedhëse bankare në euro dhe lekë pranë bankave OTP Albania dhe Raiffeisen Albania.

9. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit dhe të tjera

Të pagueshmet për aktivitetin e shfrytëzimit deri më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Më 31 dhjetor 2023</u>
Të pagueshme ndaj palëve të treta	546,673,277	700,064,964
Total	<u>546,673,277</u>	<u>700,064,964</u>

Llogaritë e pagueshme konsistojnë kryesisht në detyrimin ndaj furnitorëve të tjerë për punime, shpenzime dhe shërbime të ndryshme.

INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

10. Të pagueshme për punonjësit dhe detyrime të tjera tatimore

Të pagueshme për punonjësit dhe detyrime të tjera tatimore deri më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Më 31 dhjetor 2023</u>
Paga dhe shpërblime	-	759,385
Detyrime tatimore	926,368	89,524,277
Total	<u>926,368</u>	<u>90,283,612</u>

11. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>
Të ardhura nga shfrytëzimi	2,431,125,060	3,334,129,002
Total	<u>2,431,125,060</u>	<u>3,334,129,002</u>

12. Lëndë e parë, puntori dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>
Situacione nenkontraktoret	1,876,652,972	2,609,565,012
Total	<u>1,876,652,972</u>	<u>2,609,565,012</u>

Shoqëria ka njohur në shpenzime të periudhës situacionimet e lidhura me kontratën.

13. Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>
Pagat e punonjësve	8,342,697	7,005,674
Sigurime Shoqërore e shëndetsore	1,084,271	873,838
Total	<u>9,426,968</u>	<u>7,879,512</u>

INC S.p.A. – Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

14. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 përbëhen nga sa mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
<i>Shpenzime interesi</i>		
Interesa bankare	5,128,465	1,051,147
Total	5,128,465	1,051,147
<i>Të ardhura nga këmbimet valutore</i>		
Fitim nga këmbimet valutore	-	-
Humbje nga këmbimet valutore	14,534,460	8,431,306
Total	19,662,924	9,482,452

15. Angazhimet dhe Pasiguritë

Nuk ka angazhime dhe pasiguri që kërkojnë paraqitje ose korigjim në pasqyrat financiare.

16. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që kërkojnë veprime rregulluese ose shënime shpjeguese përveçse sa detajuar më lart.